



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Në bazë të nenit **11pika 3 gj.** të Statutit të Kolegjit “Biznesi” në Prishtinë, Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Kolegjit “Biznesi”-Prishtinë më 27. 01. 2012 miratoi këtë:

RREGULLORE

MBI KRITERET E POSAÇME TË ORGANIZIMIT TË STUDIMEVE MASTER

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret e posaçme të organizimit, mënyrës së regjistrimit të studimeve master, kohëzgjatja, organizimi dhe mënyra e përfundimit të studimeve master, përkatësisht hartimi i tezës së diplomës për master.

Neni 2

Të gjitha njësitë akademike të Kolegjit “Biznesi”, duke u nisur nga kriteret unike të përcaktuara me këtë rregullore dhe parimin e fleksibilitetit dhe diversitetit, mund të përcaktojnë rregulla të veçanta në pajtim me veçoritë e fushave të tyre të studimit.

Neni 3

1. Studimet master kanë të drejtë t’i regjistrojnë të gjithë studentët, të cilët kanë kryer ciklin e parë të studimeve themelore (baçelor) dhe që kanë fituar së paku 180 kredi (ECTS).
2. Studentët të cilët kanë kryer ciklin e parë të studimeve, që është kompatibil me programin e studimeve për nivelin master (MA) dhe që kanë arritur notën mesatare 7.5 do të pranohen drejtpërdrejt në studimet master.
3. Studentët të cilët kanë përfunduar studimet baçelor (BA) nga lëmitë e tjera shkencore jokompatibile me programin themelore të studimeve, për regjistrim në nivelin master (MA) do t’i nënshtrohen provimeve kualifikuese nga lëndët e studimeve sipas vendimit të KLMSH, pavarësisht nga nota mesatare e studimeve të nivelit baçelor (BA).
4. Studentët me notën mesatare nën 7.5, edhe pse kanë përfunduar studimet baçelor (BA) në programin kompatibil për studimet master (MA), do t’i nënshtrohen provimit kualifikues në të gjitha njësitë akademike, në të cilat ata aplikojnë në studimet master.
5. Lëndët kualifikuese të cilat do t’u nënshtrohen kandidatet me notën mesatare të studimeve nën 7.5 për regjistrim do të caktohen me vendim të KLMSH varësisht nga fushat e studimit.

Neni 4

Studimet master do të organizohen në të gjitha njësitë akademike të Kolegjit të cilat me planet e tyre mësimore parashohin këtë shkallë të studimeve dhe kalojnë procesin e akreditimit nga AKA.

Neni 5

1. Të drejtën e dhënies së mësimit në studimet master, si rregull e ka personeli mësimor në thirrje të profesorit (Profesor i rregullt, Profesor i asocuar dhe profesor asistent) i cili i plotëson kushtet e parapara me Statutin e Kolegjit “Biznesi”. Përrjashtimisht në mungesë të personelit mësimor me thirrjen profesor, të drejtën e dhënies së mësimit në studimet master e ka edhe personeli mësimor me thirrjen shkencore Doktor i shkencave në fushën e studimeve përkatëse.
2. Personeli mësimor e humb të drejtën e dhënies së mësimit:
 - a. në rastet kur më vet dëshirë nuk dëshiron që të jetë i angazhuar në Kolegjin “Biznesi”
 - b. në rastin kur më marrëveshje Kolegjin “Biznesi” shkëputet marrëdhënia e punës

- c. në rastin kur personeli mësimor nuk i kryen detyrat e tij sipas kontratës së punës, si dhe
- d. në rastet kur janë plotësuar kushtet nga nenet 67 – 70 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212

Neni 6

1. Studimet master zhvillohen sipas sistemit modular dhe bazohen kryesisht në lëndë të ngushta të specializimit brenda njësive akademike. Sistemi i punës në këtë cikël studimesh duhet të përfshijë edhe orët e punës praktike, përkatësisht praktikën kërkimore hulumtuese të cilën duhet ta përfundojnë studentët.
2. Regjimi i studimeve, sistemi i notave, sistemi i kredive është i ngjashëm me studimet e ciklit të parë baçelor.

Neni 7

1. Secila njësi akademike në kuadrin e Kolegjit “Biznesi”, e cila organizon studimet master është e detyruar të krijojë shërbimin e veçantë për mbajtjen e evidencës dhe sigurimin e rregullt të mësimdhënies përmes shërbimit të veçantë tekniko – administrative i cili është i ndarë nga studimet e ciklit themelor.
2. Me rregulloren e organizimit të brendshëm të njësive akademike mund të përcaktohet, nëse ka nevojë, mënyra e organizimit të studimeve të ciklit master dhe organet të cilat këto njësi i formojnë për implementimin e këtyre studimeve.

Neni 8

1. Studimet master zgjasin 1 vit (për studentët që kanë kryer studimet katërvjeçare) dhe 2 vite (për studentët që kanë kryer studimet trevjeçare) kërkojnë arritjen e 60 përkatësisht 120 ECTS, nëse me programe të veçanta nuk përcaktohet ndryshe.
2. Transferi i studentëve në studimet master (MA) në Kolegjin “Biznesi” nga institucionet e tjera të arsimit të lartë mund të bëhet në fillim të çdo semestri të vitit akademik, pas procedurës së vlerësimit dhe ekuivalentimit të notave dhe programit të studimit.
3. Për vlerësim dhe ekuivalentin të notave dhe programeve për pranimin dhe transferin e studentëve në nivelin master (MA) në Kolegjin “Biznesi”, nga KLMSH krijohet një komision i posaçëm për vlerësim dhe ekuivalentim.

Neni 9

1. Të gjitha provimet e studimeve master të Kolegjit “Biznesi” përfundojnë me punimin e tezës për master në pajtim me programet e studimeve.
2. Punimi për master elaborohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar së aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushat e caktuara profesionale dhe shkencore.
3. Punimi i diplomës për master mund të elaborohet nga dy ose tre studentë (grupi kërkimor) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
4. Aplikimi për elaborimin e punimit të diplomës për master nga dy ose tre studentë vendoset nga KLMSH.
5. Procedura për paraqitje, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për master përcaktohet nga KLMSH.
6. KLMSH i Kolegjit “Biznesi” me vendim të veçantë do të vendosë për numrin e temave të diplomës-tezes master për të cilat një mësimdhënës mund të jetë mentor gjat një viti akademik., si dhe shumën e pagesës për mentorin dhe anëtarët e komisionit për mbrojtjen e tezës për master.

Neni 10

1. Të gjitha njësitë akademike të cilat organizojnë studime master janë të detyruara që të dorëzojnë planet dhe programet mësimore më së voni tre muaj para fillimit të realizimit të programit Këshillit të

Lartë Mësimor-Shkencor.

2. Njësitë akademike mund të organizojnë programe interdisiplinare të studimeve pasdiplomike të ciklit master.
3. Njësitë akademike në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të Kolegjit “Biznesi” mund të organizojnë studime të ciklit master me njësi akademike, përkatësisht fakultete të universiteteve ndërkombëtare.

Neni 11

TEZA E MASTERIT

- 11.1. Çdo program i ciklit të dytë të studimeve kërkon tezë të shkruar (tezë të masterit), e cila mbrohet në mënyrë publike .
- 11.2. Kusht për të paraqitur tezën është dhënia e të gjitha provimeve, respektivisht studentet që kanë më së shumti dy provime të pa përfunduara sipas programit të studimeve.
- 11.3. Temën e tezës, studentit e zgjedh në konsultim me profesorët e lëmisë përkatëse.
- 11.4. Në semestrin e dytë (për studentët në programin e studimeve një vjeçare të masterit), respektivisht në semestrin e katërt (për studentët në programin e studimeve dy vjeçare të masterit), studentit mund t’ia dorëzojë *propozimin* për lejimin e tezës së masterit Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit.
- 11.5. *Propozimteza*, paraqitet, duke plotësuar një formular të veçantë, i cili merret në *ueb* faqen e Kolegjit / “Biznesi” ose në Zyrën për master.
- 11.6. Në afat prej 30 ditëve, pas dorëzimit të propozimtezës, dekani thërret Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit, i cili e shqyrton përshtatshmërinë e propozim tezës dhe të kandidatit.
- 11.7. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit “Biznesi”, në të njëjtën mbledhje, cakton mentorin nga fusha e ngushtë, i cili do të jetë burimi kryesor akademik dhe administrativ i studentit për përpilimin e tezës.
- 11.8. Në raste të jashtëzakonshme dhe për shkaqe të arsyeshme, kandidati mund të kërkojë ndërrimin e mentorit. Në raste të tilla, Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor në afat prej 30 ditësh merr vendimin përkatës.
- 11.9. Titulli i tezës së miratuar shpallet në *ueb* faqen Kolegjit “Biznesi” dhe evidentohet në librin e veçantë të Kolegjit.
- 11.10. Numri i faqeve të tezës, duhet të jetë, jo më pak se 60 faqe dhe jo më shumë se 80 faqe.
- 11.11. Struktura e tezës së masterit duhet të përmbajë:
 - Ballinën*
 - Përkushtimin (nëse ka)*
 - Rezymetë*
 - Përshkrimin e përmbajtjes*
 - Përmbajtjen në kapituj*
 - Konkluzionet*
 - Bibliografinë*
- 11.12. Ballina e tezës së masterit duhet të përmbajë:
 1. *Emrin e Kolegjit “Biznesi” (në anën e majtë-lartë të faqes)*
 2. *Emrin e Programit (në anën e djathtë-lartë të faqes)*
 3. *Logon e Kolegjit “Biznesi”*
 4. *Titullin e temës (në mes të faqes)*
 5. *Emrin dhe mbiemrin e kandidatit (në anën e majtë-poshtë të faqes)*
 6. *Emrin dhe mbiemrin e mentorit (në anën e djathtë-poshtë të faqes)*
 7. *Muajin dhe vitin e mbrojtjes së tezës së masterit (në mes të rreshtit-në fund të faqes)*

- 11.13. Pamja e ballinës së punimit të masterit, më detajisht, do të përshkruhet në udhëzimin për pamjen e ballinës, të cilin e sjell Zyra për studime master.
- 11.14. Pas përfundimit të shkruarjes së tezës së masterit, mentori i raporton Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të Kolegjit “Biznesi”.
- 11.15. Pas raportit të pranuar nga mentori, KLMSH, në një afat prej 15 ditëve, cakton Komisionin për vlerësimin e tezës së kompletuar.
- 11.16. Komisioni për vlerësimin e tezës së kompletuar, në afat prej jo më shpejt se 15 ditë dhe jo më gjatë se 45 ditë nga marrja e vendimit, duhet t’i raportojë Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, në lidhje me vlerësimin e tezës.
- 11.17. Komisioni, kandidatit mund t’ia kthejë hulumtimin me vërejtjet eventuale, më së shumti dy herë dhe t’i caktojë një afat, më së shumti prej 3 muajve, me qëllim të përmirësimit të tyre.
- 11.18. Pas vlerësimit pozitiv nga Komisioni përkatës, Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, në afat prej 15 ditëve, cakton Komisionin për mbrojtjen e tezës.
- 11.19. Komisioni për mbrojtjen e tezës mund të përbëhet nga të njëjtët anëtarë, të cilët e përbëjnë Komisionin për vlerësimin e tezës.
- 11.20. Në rastet kur përbërja e Komisionit për mbrojtjen e tezës së masterit ndryshon nga përbërja e Komisionit për vlerësimin e tezës, atëherë ai është i obliguar ta vlerësojë hulumtimin dhe në afat më së shumti prej 45 ditëve, ta informojë kandidatin për vërejtjet eventuale.
- 11.21. Deri në shkrimin e tezës së masterit, kandidati, së paku, një herë, duhet të raportojë para Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, nëse kjo kërkohet nga KLMSH.
- 11.22. Pas vlerësimit përfundimtar, Komisioni për mbrojtjen e tezës së masterit përgatitë raport, të cilin ia dorëzon KLMSH.
- 11.23. Pas miratimit të raportit, Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor e cakton datën e mbrojtjes, në një afat mbrenda 15 ditësh nga dita e miratimit të raportit. Në rast se Këshilli Mësimor Shkencor nuk e miraton raportin, atëherë procesi i përgatitjes së tezës së masterit duhet të rifillojë sërish. Në këtë rast, Këshilli Mësimor Shkencor jep sqarime dhe udhëzime me shkrim.
- 11.24. Kandidati njoftohet me shkrim për datën e mbrojtjes së tezës së masterit.
- 11.25. Teza e masterit mund të punohet dhe publikisht të mbrohet në gjuhën shqipe, si rregull, përjashtimisht edhe në gjuhën angleze, sipas kërkesës së kandidatit.

Neni 12

Mbrojtja e tezës së masterit

- 12.1. Kandidati, publikisht e mbron tezën e masterit para Komisionit për mbrojtje.
- 12.2. Dita dhe vendi i mbrojtjes publike, emri i kandidatit dhe titulli i tezës së masterit publikohen në *ëeb* faqen e Kolegjit “Biznesi”, së paku, 7 ditë, para mbrojtjes publike të tezës së masterit.
- 12.3. Mbrojtja e tezës së masterit zhvillohet në ambientet e Kolegjit “Biznesi”.
- 12.4. Komisioni për mbrojtjen e tezës përbëhet prej 3 anëtarëve, prej të cilëve më shumë se 50 % duhet të jenë ekspertë të lëmisë.
- 12.5. Para mbrojtjes, emërohet kryetari i Komisionit për mbrojtje publike nga radhët e Komisionit për mbrojtje publike.
- 12.6. Mentori nuk mund të jetë kryetar i Komisionit për mbrojtjen e tezës.
- 12.7. Për rrjedhën e mbrojtjes publike mbahet procesverbali zyrtar, të cilin e nënshkruajnë anëtarët e Komisionit.
- 12.8. Mbrojtja e tezës së masterit zhvillohet sipas rendit në vijim:
- Kryetari i Komisionit, mban fjalën hyrëse, me të cilën e hap mbrojtjen publike.
 - Sekretari i Kolegjit “Biznesi” i lexon shënimet biografike të kandidatit dhe aktivitetin e tij shkencor.
 - Kryetari i Komisionit, lexon recensionin me vlerësimin e Komisionit për tezën e masterit

- Kryetari i Komisionit, fton kandidatin që ta prezantojë dhe arsyetojë tezën e masterit.
 - Kryetari i Komisionit, ia jep fjalën mentorit dhe anëtarëve të Komisionit, që ta shprehin mendimin e tyre për tezën e masterit.
 - Anëtarët e Komisionit i bëjnë pyetje kandidatit.
 - Komisioni tërhiqet për të marrë vendimin lidhur me mbrojtjen e tezës së masterit.
- Notimi i tezës së masterit bëhet me njërën nga këto dy nota përshkruese:
- *nuk e mbrojti tezën e masterit*
 - *e mbrojti tezën e masterit.*

Neni 13 **Kufizimet**

- 13.1. Qëllimi i kufizimeve është të sigurojë që diploma e studimeve master e Kolegjit “Biznesi” përfaqëson zotërim të njohurive aktuale në fushën e studimit.
- 13.2. Teza e masterit duhet të përfundohet për një periudhë jo më tepër se katër vite kalendarike nga regjistrimi i studentit në programin e studimeve pasdiplomike, që do të thotë jo më shumë se dy vite kalendarik nga momenti i paraqitjes së *propozim-tezës*.
- 13.3. Në qoftë se studentit në konsultim me mentorin e shohin të përshtatshme dhe janë gati që kandidati të mbrojë tezën në fund të semestrit të tretë, atëherë mund të veprojnë kështu.
- 13.4. Në rrethana të jashtëzakonshme, kandidati mund të aplikojë për një vazhdim të kufizimeve.
- 13.5. Kërkesa duhet të pranohet nga drejtori i Zyrës për studime master dhe t’i dorëzohet dekanit lidhur me vendimin përfundimtar.
- 13.6. Çdo student, i cili do të kërkojë vazhdim të kufizimeve, duhet të jetë gati të demonstrojë përgatitje për kompletimin e të gjitha kërkesave të programit.

Neni 14 **Leje për mungesë**

- 14.1. Në kushte të veçanta, studentit në studimet master, mund t’i jepet një herë leje për mungesë.
- 14.2. Studentëve të studimeve master, maksimum mund t’u jepet një vit mungesë.
- 14.3. Periudha dhe arsyeja e mungesës duhet të jepen në mënyrë paraprake dhe të aprovohen nga dekani ose i emëruari i tij/saj.
- 14.4. Vetëm studentëve me sukses të mirë akademik do t’u aprovohet kërkesa për mungesë.
- 14.5. Në qoftë se aprovohet koha e mungesës (pushimit), ajo nuk duhet të llogaritet përkundrejt kohës së përgjithshme, përderisa studentit duhet t’i mbarojë studimet.
- 14.6. Ripranimi pas një pushimi të miratuar është formalitet.
- 14.7. Studentët, të cilët marrin një pushim të pa aprovuar, kanë mundësi, që nga ana e dekanit dhe përgjegjësit të Studimeve master, në mënyrë diskrecionale, të ripranohen në Kolegjin, por duhet t’i mbarojnë kërkesat e Programit, brenda statutit të kufizimeve të caktuara në regjistrimin origjinal.

Neni 15 **Tërheqja nga studimet**

- Në qoftë se një student do të tërhiqet nga studimet në Kolegjin “Biznesi”, ai /ajo duhet:
- Të mos kenë obligime të pagesave tek zyra e pagesave;
 - Të kontrollojnë, me shërbimin e bibliotekës, në qoftë se kanë marrë libra;
 - Të plotësojnë, në Zyrën e regjistrimit, formularin për tërheqje;
 - Të marrin dokumentet dhe t’i kthejnë kartat e identifikimit;

Neni 16

Titulli Master

- 16.1 Në të gjitha programet e ciklit të dytë të studimeve në Kolegjin “Biznesi”, duhet që më së paku, të grumbullohen 60 ECTS kredi për programin një vjeçar të studimeve respektivisht të grumbullohen 120 ECTS kredi për programin dy vjeçarë të studimeve master.
- 16.2 Pas përfundimit të suksesshëm të studimeve master, fitohet titulli shkencor master i lëmisë përkatëse.

Neni 17

E drejta e autorit

- 17.1. Kandidati, para aprovimit të tezës, nënshkruan një deklaratë, me të cilën Kolegjit “Biznesi” ia kalon të drejtat autoriale të punimit.
- 17.2. Stafii dhe studentët kanë të drejtën e autorit, duke përfshirë të drejtën në mbarë botën, për punime të shkruara si: libra, artikuj, punime arsimore, punime seminarike, ku janë të paraqitura rezultatet e hulumtimit akademik ose studimit.
- 17.3. Kolegji “Biznesi” i ruan të gjitha të drejtat e përdorimit të punimeve të lartpërmendura, për qëllime edukativo-arsimore dhe hulumtuese.

Neni 18

Plagjiatura

Teza e masterit duhet të jetë punim origjinal i autorit. Është e ndaluar çdo formë e kopjimit nga punimet e publikuara nga autorë tjerë, të pacituara, dhe ne kundërshtim me metodologjinë shkencore që kanë elemente të plagjiaturës. Kur kemi të bëjmë me plagjiaturë të tezave të masterit do të veprohet në pajtim me ligjet përkatëse në Republikën e Kosovës, Statutin dhe rregulloret e brendshme të Kolegjit “Biznesi”

Neni 19

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e KMLSH të Kolegjit “Biznesi”.

Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

Dekan